

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetar, Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarve Sh.L., I.Q. dhe F.B. për shkak të veprës penale Grabitja në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 31 dhe nenin 81 të KP-së, i akuzuari Sh.K. për shkak të veprës penale të Grabitjes nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 31 të KP-së, të akuzuarit Xh.Q., M.B. dhe L.L. për shkak të veprës penale Dhënie e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 të KP-së, i akuzuari A.D. për shkak të dy veprave penale Dhënie e ndihmës pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 të KP-së dhe veprën penale të Kanosjes nga neni 185 par.1 të KP-së, i akuzuari D.A. për veprën penale Moslajmërim i veprave penale apo kryeseve të tyre nga neni 386 par.1 të KP-së si dhe veprën penale Dhënia e ndihmës par kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 të KP-së, i akuzuari V.B. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ankesave të mbrojtësve të akuzuarve, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.659/16 datë 03.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 06.03.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohen si të pa bazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Prishtinë si dhe ankesat e parashtruara nga mbrojtësit e të akuzuarve M.B. dhe L.L..

II. Aprovohen ankesat e mbrojtësve të akuzuarve Sh.L., I.Q. dhe F.B., Sh.K. dhe V.B., si të bazuara, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.659/16 datë 03.11.2017, vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarve Sh.L., I.Q. dhe F.B. i gjykon secilin veç e veç me dënim me burg në kohëzgjatje prej nga 4 (katër) vite e 6 (gjashtë) muaj në të cilin dënim do t'iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 26.06.2014 dhe dënimin me gjobë secili veç e veç nga 6000 (gjashtë) mijë euro, të akuzuarin Sh.K. e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim prej datës 26.04.2014 deri me 22.03.2016 si dhe dënime gjobë në shumë prej 2000 (dy mijë) euro, ndërsa të akuzuarin V.B. e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro.

III. Aktgjykimi përkitazi me të akuzuarit Xh.Q., D.A. dhe A.D. ngel i pa shqyrtuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.659/16 datë 03.11.2017, i ka shpallur fajtor dhe atë të akuzuarin **Sh.L.** për shkak të veprës penale në bashkëkryerje e në vazhdimësi Grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-ës, për çka e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vitesh në të cilin dënim i llogaritet qëndrimi në paraburgim prej datës 26.06.2014 e tutje si dhe dënim me gjobë në shumën prej 10000 euro të cilin dënim duhet ta përmbush në afat prej 3 muajsh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit në të kundërtën nëse nuk përmbushet brenda këtij afati dënimi me gjobë do të i zëvendësohet me dënim burgim ashtu që për një natë burgimi vlen 20 euro. Të akuzuarin **I.Q.** e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Grabitja në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 31 dhe nenin 81 të KP-së për çka e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vitesh në të cilin dënim i llogaritet qëndrimi në paraburgim prej datës 26.06.2014 e tutje si dhe dënim me gjobë në shumën prej 10000 euro të cilin dënim duhet ta përmbush në afat prej 3 muajsh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit në të kundërtën nëse nuk përmbushet brenda këtij afati dënimi me gjobë do të i zëvendësohet me dënim burgim ashtu që për një natë burgimi vlen 20 euro. Të akuzuarin **F.B.** e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Grabitja në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 31 dhe nenin 81 të KP-së për çka e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vitesh në të cilin dënim i llogaritet qëndrimi në paraburgim prej datës 26.06.2014 e tutje si dhe dënim me gjobë në shumën prej 10000 euro të cilin dënim duhet ta përmbush në afat prej 3 muajsh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit në të kundërtën nëse nuk përmbushet brenda këtij afati dënimi me gjobë do të i zëvendësohet me dënim burgim ashtu që për një natë burgimi vlen 20 euro. Të akuzuarin **Sh.K.** e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale të Grabitjes nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 31 të KP-së për çka e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 6 (gjashtë) muaj në të cilin dënim do ti llogaritet qëndrimi në paraburgim prej datës 26.06.2014 deri me 22.03.2016 (1 vit e 9 muaj) si dhe dënim me gjobë në shumë prej 4000 euro të cilin dënim detyrohet ta përmbush në afat prej 3 muajsh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit në të kundërtën nëse nuk përmbushet brenda këtij afati dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim burgim ashtu që për një natë burgim vlen 20 euro. Të akuzuarin **Xh.Q.** për shkak të veprës penale Dhënie e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 të KP-së për çka e ka gjykuar me dënim burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti në të cilin dënim i llogaritet qëndrimi në paraburgim prej datës 09.08.2014 deri me 22.03.2016 (1 vit e 7 muaj e 13 ditë). Të akuzuarin **M.B.** për shkak të veprës penale Dhënie e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 të KP-së për çka e ka gjykuar me dënim burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti në të cilin dënim i llogaritet qëndrimi në paraburgim prej datës 09.08.2014 deri me 22.03.2016 (1 vit e 7 muaj e 13 ditë). Të akuzuarin **A.D.** për veprën penale Dhënie e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 të KP e ka gjykuar me dënim burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti kurse për veprën penale Kanosje nga neni 185 par.1 të KP e ka gjykuar me dënim burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh. Në kuptim të nenit 80 të KP i është shqiptuar dënim unik me burg prej 1 (një) vit e 5 (pesë) muaj në të cilin dënim i llogaritet qëndrimi në arrest shtëpiak prej 12.07.2014 deri me 23.07.2014 dhe koha e kaluar në paraburgim prej 23.07.2014 deri me 22.03.2016 (1 vit e 8 muaj e 10 ditë). Të akuzuarin **L.L.** për shkak të veprës penale Dhënia e ndihmës kryerësit pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 të KP, për çka e ka gjykuar me dënim burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit në të cilin dënim do ti llogaritet qëndrimi në paraburgim prej datës 22.08.2014 deri me 09.12.2015 (1 vit e 7 muaj). Të akuzuarin **D.A.** e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 388 par.1 të KPK, për çka e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muaj në të cilin dënim i llogaritet qëndrimi në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 09.07.2014 deri me 05.04.2015 (8 muaj

e 26 ditë). Të akuzuarin **V.B.** e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK për çka e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 1000 euro të cilën mund ta përmbush me dy këste (rata) në të kundërtën ky dënim do ti zëvendësohet me dënim burgimi ashtu që për një natë burgim vlen 20 euro. Në kuptim të nenit 62 par.2 pika 2.6 të KP u shqiptohet **Dënim plotësues:** Konfiskimi i revoles “Ekol Special 95” kalibri 9 mm me numër serik EV1235432 me katër fishek të kalibrit 7.65 mm e konfiskuar nga i akuzuari V.B.. “Iphone 5” i bardh me numër serik IMEI 013621006861494 i konfiskuar nga i akuzuari Sh.L.. Vetura e tipit “Opel Omega 4/T” ngjyrë hiri me numër identifikues ËOL 000027V1033789. Ndërsa i kthehen të dëmtuarit V.P. stolit e identifikuar sipas katalogut dhe çmimeve që i ka pasur në posedim. Gjithashtu të kthehen bizhuteritë e konfiskuara me rastin e bastisjeve pronareve në vendet ku është bërë konfiskimi. Vetura “Golf 4” i është kthyer pronarit F.R. e ngjyrës së kuqe me targa të regjistrimit RKS 01 683 FD. Të akuzuarit L.L. i kthehet vetura – automjeti Kombi “Renault” trafik me targa të regjistrimit 01-195-BA si dhe librezja e qarkullimit të veturës me numër CRA – 0047198 të sekuestruara nga NJHR në Prishtinë. Të akuzuarit Sh.L., I.Q., F.B., Sh.K. në kuptim të nenit 463 të KPP obligohen që në mënyrë proporcionale –solidare të ia kompensojnë dëmin e shkaktuar të dëmtuarit V.P. në shumë prej 38.000 euro. Në kuptim të nenit 463 të KPP obligohen të akuzuarit Sh.L., I.Q., A.B. t’ia kompensojnë dëmin TEB bankës në shumë prej 39.930 euro pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I dëmtuari S.P. është tërhequr nga kërkesa pasurore-juridike. Të dëmtuarit e tjerë që e konsiderojnë vetën të dëmtuar në këtë rast për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil. Në kuptim të nenit 452 të KPP obligohen të akuzuarit që të paguajnë të gjitha shpenzimet procedurale sipas flet shpenzimit ndërsa në emër të paushallit gjyqësor duhet të paguajnë i akuzuari Sh.L., I.Q., F.B., Sh.K. nga 300 euro, të akuzuarit A.D., Xh.Q., M.B. nga 200 euro, të akuzuarit D.A., L.L. dhe V.B. nga 150 euro pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Konform nenit 364 është liruar nga akuza i akuzuari D.A. për shkak të veprës penale Moslajmrim i veprave penale apo kryerësve të tyre nga neni 386 par.1 të KPK. Shpenzimet e procedurës penale bien barrë e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

-Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së Ligjit Penal dhe vendimit mbi sanksionin penal duke propozuar që kjo gjykatë ta aprovoj ankesën dhe ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë në atë mënyrë që të pandehurin D.A.n ta shpall fajtor edhe për veprën penale Moslajmërim i veprave penale apo i kryerësve të tyre nga neni 388 par.1 dhe ta dënoj sipas ligjit ndërsa të pandehurve Sh.L., I.Q., F.B., Sh.K., Xh.Q., M.B., L.L. dhe A.D. tiu caktoj një dënim më të lartë me burgim.

- Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.L. av. N.R., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së Ligjit Penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e tij, ta anuloj aktgjykimin e nxjerr ndaj Sh.L.t dhe të tjerëve.

- Mbrojtësi i të akuzuarit I.Q. av. L. I, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së Ligjit Penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e sajë ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim apo ta ndryshoj dhe të nxjerr aktgjykim lirues për të akuzuarin.

-Mbrojtësi i të akuzuarit F.B. av. T.R. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së Ligjit Penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tersi ankesën si të bazuar, aktgjykimin e

shkallës së parë ta anuloj ashtu që të akuzuarin ta liroj nga akuza ose çështjen ta kthej në rigjykim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.K. av. A.Gj., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar kurse aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj të akuzuarin ta liroj nga akuza ose të njëjtin aktgjykim ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit M.B. avokati M.H., për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe të akuzuarin M.B. ta liroj nga akuza ose lëndën ta kthej në rigjykim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit L.L. av. B.Sh. për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal me propozim që ankesa të aprovohet dhe i njëjti të lirohet nga përgjegjësia penale.

-Mbrojtësi i të akuzuarit V.B., av. B.K. për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën, aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënim ashtu që dënimin me gjobë në lartësi prej 1000 euro ta zbut ndaj të akuzuarit V.B..

-Përgjigje në ankesë ka parashtruar mbrojtësja e të akuzuarit A.D. av. F.G.-B., me propozim që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë të hudhet poshtë si e pa bazuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në të cilën nuk prezantuan Prokurori i Apelit mbrojtësi i të akuzuarit Sh.K. av. A.Gj., mbrojtësi i të akuzuarit M.B. av. M.H., i akuzuari Ahmet Dulla dhe mbrojtësja e tij av. F.G.-B., përfaqësuesi i të dëmtuarit V.P. av. H.M. edhe pse të ftuar me rregull, ndërsa prezent ishin i akuzuari Sh.L. dhe mbrojtësi i tij av. N.R., i akuzuari I.Q. dhe mbrojtësi i tij av.L.B., i akuzuari F.B. dhe mbrojtësi i tij zëvendësues i av. T.R. av.M. Neziri, i akuzuari Sh.K., i akuzuari Xh.Q., i akuzuari M.B., i akuzuari L.L. dhe mbrojtësi i tij B.Sh., i akuzuari D.A., i akuzuari V.B. dhe mbrojtësi i tij av. B.K., përfaqësuesi i të dëmtuarës Teb Bank A.K., përfaqësuesi i të dëmtuarës Hotel “Sëiss Daimond” zëvendësues i S.P.t, S.K. Përfaqësuesit e palëve të dëmtuara mbështesin ankesën e prokurorit. Mbrojtësit qëndrojnë pranë pretendimeve ankimore të bëra në ankesat e tyre, kurse te gjithë akuzuarit prezent mbështesin fjalët e mbrojtësve të tyre.

- Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.57/2018 të dt. 09.02.2018 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë të aprovohet ndërsa ankesat e mbrojtësve të akuzuarve dhe përgjigja në ankesë të refuzohen si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesat janë të pa bazuara:

Në ankesë Prokuroria pretendon se vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes dhe shkeljes së ligjit penal ka të bëjë me pjesën e aktgjykimin sa i përket të pandehurit D.A. pasi konsiderojmë se gjykata nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike kur ka gjetur se i pandehuri

D.A. nuk ka kryer edhe veprën penale Moslajmërimi i veprave penale nga neni 386 të KPK të cilin lirim gjykata fare nuk e ka arsyetuar por ka theksuar se është bërë në mungesë të provave. Mirëpo me vetë faktin se i pandehuri D.A. natën kritike e ka thirrur të akuzuarin A.D. duke e informuar të njëjtin se policia e ka thirrur lidhur me veturën Opell Omega e cila ishte përdorur për ta kryer veprën penale të grabitjes në bankë tregon se i njëjti ka ditur por nuk ka dashur ta lajmëroj veprën penale në fjalë. Në kuadër të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike rrjedh edhe shkelja e ligjit penal duke e favorizuar të akuzuarin D.A. duke e liruar të njëjtin nga akuza në mungesë të provave për çka konsiderojmë se ka miftueshëm prova. Ndërsa në pjesën e aktgjykimit sa i përket të akuzuarve Sh.L., I.Q., F.B., Sh.K., Xh.Q., M.B., L.L. dhe A.D. konsiderojmë se vendimi mbi sanksionin penal është i butë dhe se ndaj tyre është dashur që të shqiptohet dënimi më i lartë me burg me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit.

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet, nga ana e mbrojtjes së të akuzuarit **Sh.L. av. N.R.**, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nënpar.1.8, ”pasi që aktgjykimi sipas mbrojtjes bazohet në prova të pa pranueshme” dhe par.2 nën. par. 2.1 “nuk kanë zbatuar ndonjë dispozitë të këtij kodi ose kanë zbatuar gabimisht” të KPPRK. Gjykata e bazon aktgjykimin në prova të pa pranueshme sepse falë besimin deklaratave që janë dhënë nga dëshmitarët të cilët nuk kanë mundur të dëshmojnë asgjë konkrete për Sh.L.n si dhe deklarata e tyre në të cilat gjykata ka mbështetur aktgjykimin dënues kanë qenë deklarime supozuese ndërsa nuk kanë pasur asgjë konkrete reale dhe të besueshme. Po ashtu dëshmitarët të cilët edhe kishin qenë bartës së këtij rasti nga policia e Kosovës e të cilët ishin dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve rrëfimin e tyre e kanë bazuar kryesisht në një dëshmitar anonim të cilin për asnjë moment nuk kanë qenë në gjendje ta paraqesin për dëgjim. Ne kemi propozuar që ai dëshmitar anonim të merret në pyetje në gjykatë por ai nuk është ftuar asnjëherë. Mosparaqitja e atij dëshmitari e vene në pikëpyetje nëse ndonjëherë ka ekzistuar ai dëshmitar apo jo. Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj Sh.L. ka shkelur shumë dispozita ligjore dhe se vendimi i ndërmarrë nuk ishte në përputhje me Ligjin me ç rast edhe janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Gjykata, Prokurori i Shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurë detyrohen që saktësisht dhe tërësisht ti vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm. Shkelje të Ligjit Penal kemi pasi nuk qëndron asnjë dëshmi komplete që do të përbënte provë se ekziston cili do dyshim sado i vogël që i mbrojturi i im të ketë qenë i involvuar në këtë vepër. Duke u bazuar në nenin 361 të par.1 KPRK thuhet se gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në fakte dhe prova dhe kjo dispozitë ligjore nuk është marrë për bazë fare sepse në shqyrtim gjyqësor nuk është proceduar asnjë provë apo fakte që ka të bëjë me Sh.L.. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ekziston kur gjykata ka vërtetuar gabimisht ndonjë fakt të rëndësishëm apo kur përmbajtja e dokumentit, procesverbalit mbi provat e shqyrtuara ose të incizimit teknik vënë në pikëpyetje saktësinë ose bazueshmërinë e vërtetimit të fakteve të rëndësishme dhe se vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ekziston kur gjykata nuk ka vërtetuar ndonjë fakt të rëndësishëm. Sikur të administroheshin drejtë dhe ligjërisht të gjitha dëshmitë Sh.L. do të duhej të lirohej nga akuza, po ashtu gjykata ka bërë edhe një vërtetim tjetër të gabuar ku edhe pas procedurës në rigjykim çështja nuk do të duhej të gjykohej në dëm të dënuarve pasi që ligjërisht nuk mund të keqësohet pozita e të dënuarit pasi që aprovohet ankesa. Gjykata në rigjykim kishte hekur një vit burgim por kishte shqiptuar dënimi me gjobë 10.000 euro gjë që në rastin konkret është tejkalar dënimi i mëhershëm.

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet, nga ana e mbrojtjes së të akuzuarit **I.Q. av. L.B.** për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 të KPRK pasi që dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyet e dhëna në arsyetim. Gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se për cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara duke mos dhënë arsyet në të cilat është bazuar me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të

akuzuarit. Duke qenë se aktgjykimi i ankimuar është marrë në shkelje esenciale të theksuara ka ardhur edhe deri tek shkelja e Ligjit Penal e që kjo ka ndikuar në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Po ashtu gjykata ka bërë ricilësimin e veprave penale e cila është në dëm të akuzuarit. Gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar në mënyrë të gabuar gjykata ka administruar provat por ka vlerësuar gabimisht domethënien e tyre duke nxjerr përfundim të gabuar lidhur me ekzistimin por edhe mos ekzistimin e fakteve. Duke konsideruar se në asnjë mënyrë nuk është provuar fajësia e të pandehurit gjykata është dashtë të merr aktgjykim lirues.

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet, nga ana e mbrojtjes së të akuzuarit **F.B. av. T.Rr.**, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nën. par 12 lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPRK sepse gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit nuk ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, nuk ka paraqitur asnjë arsye të vetme lidhur me pretendimet e mbrojtjes të paraqitura në fjalën përfundimtare. Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin nuk e ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë të cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara, nuk ka vlerësuar në mënyrë të veçantë saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve dhe as arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjedhjes së çështjeve juridike veçanërisht me vërtetimin e ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit. Mbrojtja thekson se aktgjykimi i kundërshtuar është i pa kuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyet e aktgjykimit. Mbështetja e aktgjykimit vetëm në dyshime të pa vërtetuara të policisë se të akuzuarit kanë mund me i krye grabitjet është një vlerësim i gabuar i gjykatës së shkallës së parë i bazuar në thashetheme që nuk mund të vërtetohen ndërsa është e pa kuptueshme se gjykata nuk mund ta mbështes vendimin në thashetheme. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e mbështetë në dëshminë e dëshmitarëve të cilët lidhur me grabitjen vetëm deklarojnë “grabitjet i kanë kryer katër persona me maska dhe të armatosur por asnjëri nga dëshmitarët nuk e ka bërë identifikimin e z.B.”. Nga kjo del se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e kundërshtuar e mbështetë me thashetheme të cilat nuk kanë mundë të vërtetohen. Gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat e nenit 384 par.2 shkelje e të drejtave të mbrojtjes që kanë qenë me ndikim në marrjen e aktgjykimit jo të ligjshëm dhe jo të drejtë lidhur me nenin 3 par.1 – prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe In Dubio Pro Reo që paraqet shkeljen e dispozitave dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të pa anshëm. Mbrojtja vëren se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të saktë se cilat veprime inkriminuse i ka kryer i mbrojturi i im. Gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar gabimisht dhe në mënyrë të njëanshme të gjitha deklaratat e dëshmitarëve. Nga aktgjykimi i kundërshtuar del se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar në mënyrë të veçante saktësinë e provave kundërthënëse ndërsa provat në të cilat e ka mbështetë aktgjykimin i ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme dhe në mënyrë të gabuar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 të KPRK.

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet, nga ana e mbrojtjes së të akuzuarit **Sh.K. av. A.Gj.**, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPRK nga se dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, me të nuk janë paraqitur arsyet mbi faktet vendimtare ekziston një kontradiktë në mes të asaj që paraqitet në arsyetim mbi përmbajtjen e dokumenteve ose të procesverbaleve, shkelje këto që aktgjykimin e bëjnë të pa qëndrueshëm. Gjithashtu aktgjykimi nuk është përpiluar konform dispozitave të nenit 370 par.7 të KPPK nga se në të nuk janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe konkrete shkaqet dhe arsyet për çdo pikë të aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë vetëm citon respektivisht përshekruan deklaratat e dëshmitarëve ndërsa nuk jep vlerësimet e tyre se cilës provë ia fal besimin dhe cilës jo dhe për këtë nuk jep arsyetimin e duhur. Gjykata ka paraqitur deklaratat e dëshmitarëve N.C. dhe Mirsad Maqastena por nuk ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit siç detyron dispozita e nenit 370 par.6 të KPPK.

Gjykata e shkallës së parë ka tentuar sadopak ta ndryshoj dispozitivin e aktakuzës por prape përshkrimi faktik i dispozitivit është në tersi në kundërshtim me provat materiale dhe formale të administruara në shqyrtim gjyqësor ashtu që ka kundërshtuar siç është cekur më sipër në mes arsyetimit dhe dispozitivit. Të gjithë dëshminë që e ka dhënë dëshmitari E.K. janë hipoteza, vlerësime hipotetike dhe paushallë që nuk kanë mbështetje në asnjë provë materiale të administruar. Gjykata e shkallës së parë duke mos e vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në mënyrë të gabuar e ka zbatuar të drejtën materiale në dëm të mbrojturit Sh.K. kur të njëjtin gjykata e shkallës së parë e shpalli fajtor nga se me provat e administruara nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale apo të ketë ndërmarrë ndonjë veprim përgatitor për kryerjen e veprës penale. Mbrojtja konsideron se nga provat e administruara në këtë çështje nuk është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit siç pretendon gjykata e shkallës së parë dhe me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi im të ketë kryer apo ndërmarrë ndonjë veprim inkriminues që paraqet tiparet e veprës për të cilën është shpallur fajtor. Edhe vendimin mbi dënim e kundërshtojmë nga se me provat e administruara nuk është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale bile në rigjykim ia ka ashpërsuar dënimin ashtu që përveç dënimit me burg i ka shqiptuar edhe dënim me gjobë.

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet, nga ana e mbrojtjes së të akuzuarit **M.B. av. M.H.** për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, mbrojtja konsideron se aktgjykimi i kundërshtuar është i paqartë, i pa kuptueshëm dhe kontradiktorë me arsyet e dispozitivit të aktgjykimit dhe i njëjti në një masë është kontradiktorë në mes asaj që paraqitet në aktgjykim dhe arsyet e tij me përmbajtjen e provave dhe fakteve të vërtetuara në shqyrtimet e mbajtura gjyqësore. Nga ky aktgjykim nuk mund të kuptohet nëse i akuzuari M. është kryes i veprës penale për të cilën është shpallur fajtor. Gjykata ka marrë një aktgjykim të tillë vetëm në bazë të një deklarate të akuzuarit Xh.Q. i cili në seancën e mbajtur ka deklaruar se e ka marrë një qesë me ari nga i akuzuari Xhemajl, kësaj deklarate gjykata ia fal besimin edhe për faktin se një gjë e tillë nuk ekziston. Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike për çka aktgjykimi i shkallës së parë duhet të priset. Nga kjo rezulton se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet, nga ana e mbrojtjes së të akuzuarit **L.L. av. B.Sh.** i cili thekson se me asnjë pikë nuk ekziston asnjë provë e cila do të mbështeste veprën penale për të cilën akuzohet i mbrojturi im, pasi që siç e kam cekur edhe në fjalën përfundimtare i mbrojturi im me asnjë veprim nuk ka kontribuar në kryerjen e kësaj vepre penale kur kihet parasysh kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje dhe në rastin konkret i mbrojturi im nuk ka asnjë njohuri se të akuzuarit e tjerë kanë kryer ndonjë vepër penale, pra i njëjti i ka transportuar dy të akuzuarit e tjerë por në asnjë moment nuk ka pasur njohuri se të njëjtit kanë mundur të kryejnë ndonjë vepër penale. Duhet cekur se me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata nuk ka vepruar drejt pasi të mbrojturin tim e ka shpall fajtor dhe ka dënuar me dënim maksimal edhe pse askund nuk cek rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e shqiptimit të dënimit.

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet, nga ana e mbrojtjes së të akuzuarit **V.B. av. B.K.** për shkak të vendimit mbi dënim , ku mbrojtja thekson se të gjitha rrethanat lehtësuese që kanë ekzistuar në kohën e marrjes së vendimit mbi dënim është dashtë të shprehen më shumë në rastin e zbutjes së dënimit. I propozoj gjykatës ndaj të akuzuarit të shqiptoj një dënim me gjobë më të butë pasi i njëjti nuk është në marrëdhënie pune dhe është mbajtës i familjes.

Përgjigje në ankesën e PTH ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit **A.D. av. F.G.-B.**, e cila ka propozuar që ankesa e Prokurorisë të hudhet si e pa bazuar si dhe të vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Dispozitivi i aktgjykimi është i qartë dhe i kuptueshëm, dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet e mjaftueshme lidhur me pjesën liruese por edhe për pjesën dënuese përkitazi me këta të akuzuar. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka marrë aktgjykimin lirues për të akuzuarin D.A. për veprën penale moslajmërim i veprës penale nga neni 386 i KPK pasi që nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk u vërtetua një pretendim i tillë i prokurorisë pasi që përveç deklaratave të akuzuarve D.A. dhe A.D. nuk pati prova tjera që vërtetojnë fajësinë për këtë vepër penale ndërsa nga dëshmia e të akuzuarit Durim vërtetohet se të akuzuarit A.D. i ka treguar që e ka thirrur policia për një kerr porse nuk ka pasur njohuri se për çka e që nga kjo nuk mund të provohet se i njëjti ka pasur njohuri e është krye ndonjë vepër penale. Në tërësi Gjykata e Apelit e Kosovës i mbështetë arsyetimet dhe vlerësimet e provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësorë si dhe me vendosjen e kësaj çështjeje penalo-juridike. Gjykata e shkallës së parë për secilën provë të administruar ka dhënë vlerësimin dhe arsyetimin e të cilat me vëmendje i ka shqyrtuar edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat materiale dhe ato jo materiale dhe atë ka bërë dëgjimin e të dëmtuarit S.P. dhe V.P., ka dëgjuar dëshmitarët N.C., M.M., B.M., B.M.2, A.B., Sh.G., K.G., B.S., S.D., E.K., N.D., F.R., I.H., A.R., G.G., S.I. dhe N.H.-M. ndërsa nga provat materiale : procesverbalin e identifikimit të arkës së “TEB Bankës” të dt. 15.09.2014 dhe fotodokumentacioni i arkës i grabitur me dt. 16.06.2014, raporti informues lidhur me lokacionet e antenave dhe hyrje daljeve telefonike të të pandehurve i dt. 25.08.2014, raporti informues nga polici hetues A.R. i dt. 18.08.2014, procesverbali me numër 00000003 i dt. 18.08.2014, lista e dëshmimeve e datës 28.05.2014, vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve i dt. 09.08.2014, njoftimi i datës 20.06.2014 lidhur me shumën e të hollave të grabitura në “TEB Bank” me dt. 16.06.2014, raporti informues i policit S.B. i dt. 01.09.2014 dhe raporti njoftues i tij i dt. 13.08.2014, njoftimi mbi rezultatin e kërkimit në sistemin Ibis lidhur me revolen Ekol special 99, raporti i policit hetues A.R. i dt. 09.07.2014, procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave të shtëpisë së akuzuarit M.B. i dt. 27.06.2014 si dhe vërtetimi i marrjes së përkohshme të gjëseneve nga ky i akuzuar i po të njëjtës datë lidhur me konfiskimin e revoles Ekol Splecial nga i pandehuri V.B., dy procesverbalet mbi identifikimin e personit përmes fotografisë i dt. 09.07.2014, numri i rastit 2014-AB-2273, vërtetimet mbi konfiskimin e gjëseneve i dt. 22.08.2014 nga i pandehuri L.L., raporti njoftues për veprimet e ndërmarra nga polici hetues A.R. i dt. 09.07.2014, vërtetimi mbi konfiskimin e gjëseneve i dt. 09.07.2014 nga i dëmtuari K.G., vërtetimi mbi konfiskimin e gjëseneve i dt. 08.07.2014, polis e sigurimit me nr. të shasisë ËOL000027VI033798, polisa e sigurimit transit me numër 120255905 i dt. 09.09.2012, procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave në shtëpinë e të pandehurit Xh.Q., vërtetimi mbi konfiskimin e gjëseneve i dt. 09.08.2014, numri i rastit 2014-AB-1975 së bashku me fotodokumentacionin e stolive të grabitura katalogu “Jewellery” lidhur me stolitë të cilat kanë qenë të vendosura në raftet e hotelit “Swis Daimond” në Prishtinë të cilën e përfaqëson pronari V.P., lista e pranimit dorzimit të stolive, artikujve të cilët kanë qenë në ekspozim në vitrinat e “Swis Diamond” hotel i datës 04.06.2014- lexohet raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i dt. 09.08.2014 lidhur me rastin e datës 28.05.2014, numri i rastit 2014-AB-1975, zingjiri i ruajtjes nr. i rastit 2014-AB-1975 së bashku me një CD me mbishkrim 2764/14 i masave të fshehta, raporti njoftues i dt. 09.09.2014 nga polici hetues S.B. nr. i rastit 2014-AB-2273, lidhur me orarin e mbajtjes së garave me automjete në regjionin e Prishtinës, katër CD, hyrja, dalja, SMS, antena dhe videoinqizime

lidhur me rastin 2014-AB-2273 lidhur me grabitjen e cila ka ndodhur në TEB Bank, tetë CD- a hyrja dalja SMS, antena dhe videoinqizime lidhur me rastin 2014-AB-1975 lidhur me grabitjen e cila ka ndodhur në hotelin “Swis Dajmond”, së bashku me zingjirin e ruajtjes e datës 17.07.2014 nga polici hetues S.B., dy CD të fotove nga procesverbali i identifikimit të stolive të cilat janë grabitur në hotelin “Svis Dajmond”, numri i rastit 2014-AB-1975. Raporti ligjor nga PTK-Vala i dt. 17.06.2014, transkripti i bisedës në mes të pandehurve L.L. dhe Sh.L. i dt. 16.06.2014. Vërtetimi mbi konfiskimin e gjëseneve i dt. 26.06.2014 nga i pandehuri Sh.L. nr. i rastit 2014-AB-1975, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 29.05.2014 lidhur me rastin 2014-AB-1975, lista e dëshmive nga njësia e forenzikës i dt. 28.05.2014, fotoalbumi i datës 28.05.2014, fotoalbumi nga Drejtoria e teknikës kriminalistike lidhur me rastin e grabitjes i dt. 16.06.2014, fotoalbumi nga njësia e forenzikës i dt. 19.06.2014. Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga njësia e forenzikës i dt. 25.06.2014 lidhur me rastin e datës 16.06.2014, fotoalbumi nga njësia e forenzikës i dt. 16.06.2014, raporti i bastisjes i dt. 26.06.2014, lista e dëshmive nga njësia e forenzikës e dt. 26.06.2014, fotoalbumi nga njësia e forenzikës i dt. 26.06.2014, raporti i ekspertizës nga njësia për ekspertim traseologjik dhe daktiloskopik i datës 18.11.2014. Konsiderohen të shikuara CD-t e shikuara më parë në shqyrtimin gjyqësor të datës 22.12.2015 me propozim dhe pajtim të palëve në procedurë, dhe nga këto prova pa mëdyshje u vërtetua se në veprimet e të akuzuarve qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën janë akuzuar dhe shpallur fajtor si dhe gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë. Për të akuzuarin Sh.K. gjykata në bazë të provave të administruara vërtetoi se i njëjti të akuzuarin H.T. i cili gjendet në arrati e ka djalë të tezës dhe se me të njëjtin një ditë para se të kryhet grabitja është takuar me te dhe me veturën e tij H.u e ka dërguar të akuzuarin Sh. dhe djalin e tij në shkollë e që duke pas parasysh mënyrën e kryerjes së grabitjes, orientimin brenda hotelit, organizimin prej hyrjes për të kryer grabitjen si dhe largimin nga hoteli pa mëdyshje vërtetojnë se të akuzuarit së bashku me të akuzuarin H.T. i cili gjendet në arrati kanë qenë të informuar dhe kanë vepruar në bashkëveprim me të akuzuarin Sh.K. e që po ashtu i njëjti përveç informimit të grupit i njëjti edhe ka hequr pengesat siç vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit N.C. ku i akuzuari Sh. ia tërheq vërejtjen të njëjtit që të pastroj terasën përball sheshit kryesor dhe pastaj duke e larguar në veturë të mysafirit të hotelit që ishte e parkuar para hyrjes kryesore për të hequr pengesat që të akuzuarit Shl.,I.F.,dhe H. t’iu lehtësohet hyrja dhe dalja nga hoteli gjegjësisht kryerja e veprës penale të grabitjes në këtë hotel. Sa i përket të akuzuarit I.Q. i njëjti ka deklaruar në prokurori se arin e vjedhur ia ka dhënë i akuzuari H.T. për ta ruajtur dhe se kurdo që ta shet të akuzuarve I. dhe F. do tua jep nga 1000 euro. Se ai dhe i akuzuari F. me të akuzuarin H. njihen që nga viti 2012 kur kanë qenë në Burgun e Dubravës. I.i pasi merr qesen me ari nuk e fsheh vet por të njëjtën ja jep F.B.t i cili e fsheh qesen me stoli dhe pas bastisjes nga policia arrestohen. Derisa të akuzuarit I., F. dhe Shkelzen kanë qenë në qendrën e paraburgimit njëherë në Pejë dhe pastaj në Dubravë, i akuzuari I. pas presionit nga i akuzuari H.T. përmes telefonit, detyrohet që ta thërret vllaun e tij Xh.Q. në vizitë dhe ja jep numrin e telefonit të akuzuarit M.B. i cili është vlla i të akuzuarit F.B., e ku M.B. ja dorëzon qesen me stoli të arit Xh.Q.t e i cili e dorëzon në shtëpinë e tij dhe të njëjtën natë arrestohet dhe shtëpia e tij bastiset ku konfiskohet qesja me stoli ari dhe me gur të çmueshëm. E gjithë kjo ngjarje pa mëdyshje vërteton se të gjithë këta të akuzuar kanë marrë pjesë në grabitje duke u njohur me njëri tjetrin dhe duke qenë shokë si dhe duke shfrytëzuar të akuzuarin Sh.K. i cili ka punuar si punëtor i sigurimit në hotel e që nga ai janë njoftuar për kohën e përshtatshme, largimin e pengesave dhe largimin nga hoteli. Pavarësisht mohimit të kryerjes së veprës penale nga këta të akuzuar nuk është kontestuese raporti familjar mes të akuzuarit Sh. dhe H.ut si dhe faktin se të akuzuarit Shkelzen, F. dhe I. kanë qenë shokë, kanë ndejtur bashkë dhe janë njohur në Burgun e Dubravës me të akuzuarin H.T.. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka bërë rikualifikimin e veprës penale për të akuzuarin Xh.Q. dhe M.B. pasi që vepra penale e rikualifikuar jo vetëm që është vërtetuar me provat materiale të cekura më lartë por kjo është pohuar edhe nga vetë këta dy të akuzuar të cilët kanë përshkruar mënyrën e pranim-dorëzimit të arit nga njëri tjetri. Sa i përket të

akuzuarit A.D. është vërtetuar se veturën Opell Omega e ka blerë nga dëshmitari K.G. e të cilën kinse ia ka shitur Sh.L.t ndërsa realisht kjo veturë është shfrytëzuar për tu grabitur TEB Banka në Bregun e Diellit veturë kjo e cila është identifikuar edhe nga dëshmitari Sami Dobërdolani i cili nga kati i dytë i bankës e ka vërejtur të njëjtën veturë, pas grabitjes që ka ndodhur në katin e parë të bankës dhe kur e njëjta është larguar nga parkingu i bankës duke ia marrë tabelat e regjistrimit me numër 01-501 BE (që kanë qenë të vjedhura dhe i kanë takuar dëshmitarit S.I.). Edhe pse asnjëri nga dëshmitarët e dëgjuar nuk kanë arritur ta bëjnë identifikimin e të akuzuarve, por vetëm kanë përshkruar ngjarjen si ka ndodhur si dhe kanë bërë përshkrimin e grabitësve, gjykata gjendjen faktike e vërtetoi në bazë të provave materiale nga të cilat vërtetohet se grabitësit janë larguar me veturën Opell Omega në drejtim të Matiçanit, se pas ndjekjes nga policia në afërsi të Liqenit të Badovcit e kanë braktisur këtë veturë si dhe veturën Golf 4 me ngjyrë të kuqe duke u larguar në drejtim të pyllit e që nga kjo rezultoi se grabitësit janë larguar me veturën Opell Omega ndërsa i akuzuari H.T. është larguar me veturën Golf 4 me ngjyrë të kuqe veturë këtë të cilën ka dashur ta blej nga dëshmitari F.R. i cili është pronar i Kompanisë për dhënie me qera të veturave. Edhe kjo gjykatë pajtohet me të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me të akuzuarin F.B. i cili ka propozuar policin N.D. si dëshmitar për të provuar se ai e ka parë të akuzuarin ditën kritike duke pir kafe në terasën e një kafiterie që gjendet pranë shkollës Iliria në Bregun e Diellit porse ky dëshmitar ka deklaruar se e ka parë pas 30 minutave pasi ka ndodhë grabitja ndërsa me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas grabitjes në bankë mënyra më e mirë për t'u ikur ndjekjes nga policia e cila i është vënë shumë shpejtë pas grabitësve ka qenë që i akuzuari F. të ndalët në teras të kafiteris dhe të pinë kafe. Të gjithë të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale të grabitjes në TEB Bank i kanë pasur telefonat e qkyqur që të mos vërtetohet vendndodhja e tyre, e këtë e ka vërtetuar edhe vllau i të akuzuarit Shl., L i cili ka deklaruar se rreth orës 17-17,30 disa herë ka tentuar ta thirr vllaun e tij Shl. por vazhdimisht i ka dalur vala 900. Shl. është thirrur edhe nga pronari i shtëpisë ku e ka pas mobilerinë por vazhdimisht i ka dalur vala 900. Se Li është shqetësuar shumë dhe ka shkuar në puntorinë e vllaun të tij në Matiçan dhe në zyret e punëtorit ka parë dy telefona Nokia dhe Iphone 5 të Shl.t të ndalur dhe të vendosur mbi tavolinë. Se ka takuar të akuzuarin I. dhe një person tjetër të cilët i kanë thënë se Shl. ka shkuar për ta dërguar një femër dhe se i akuzuari I. ka qenë i shqetësuar dhe e ka lutur të akuzuarin L që ta dërgoj tek taksistat afër xhamisë në Matiçan dhe pas lutjeve të shumta I. së bashku me shokun e tij i ka dërguar aty. Kur është nisur për shtëpi e ka thirrur vllaun i tij Shl.n me një numër të panjohur ku Shl. i ka thënë “hajde merrum se jam te A.G. që punon si berber” ndërsa ky e ka pytur Shl. se çka ka kërkuar Ibra në punëtori e që vërtetohet se të njëjtit kanë qenë mirë të pregaditur duke i ndar veprimet pas kryerjes së veprës penale ashtu që F. është ndalur në kafiteri, I.i në punëtori të Shl.t në Matiçan, njëri është largu në drejtim të Badovcit e që është Shl. dhe H.T. e që nga CD e marrë nga TEB Banka shihen se kanë qenë katër persona që kanë kryer grabitjen por pa përjashtuar mundësinë që në vëzhgim të ketë pasur edhe të tjerë. Për të akuzuarin A.D. gjykata e ka shpallur fajtor për dy vepra penale të kanosjes të cilën e pranon në shqyrtim të fundit-rigjykim pasi është vërtetuar se ka kanosur dhe kërcënuar seriozisht të dëmtuarin K.G. që ai të mos tregoj në polici se ja ka shitur veturën Opell Omega e me ç rast Kastrioti e ka ndier vehtë të kërcënuar dhe të rrezikuar e këtë e ka vërtetuar edhe në shqyrtimin gjyqësor. Se A.D. ka blerë veturën Opell Omega nga K.G., e njej Sh.L. dhe shokët e tij I.Q. dhe F.B., pasi që i njëjti ka punuar në punëtorin e Shl. në Matiçan prej nga i ka njohur edhe këta dy të tjerët. Prandaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë konsideron se me vetë faktin e blerjes së veturës Opell Omega për të cilën A.i thotë se ja ka shitur Sh.L.t, i akuzuari A. ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale të akuzuarin Sh.L.n dhe të tjerët, pasi që me të akuzuarin Shl. nuk ka pas kontratë shitblerjeje apo ndonjë marrëveshje porse është vërtetuar se veturën e ka blerë Shl. prej tij dhe se kjo veturë është përdorë në kryerjen e veprës penale të grabitjes. Edhe i akuzuari D.A. me të drejtë është shpallur fajtor për Dhënie të ndihmës pasi i njëjti ka ndërmjetësuar në shitblerjen e veturës Opell Omega, duke e informuar të akuzuarin A. se e ka thirrë policia lidhur me këtë veturë e cila veturë me datë

16.06.2014 është përdorë për kryerjen e veprës penale të grabitjes në filialën e TEB Bankës në Prishtinë. Përveç kësaj dëshmitari K.G. ka identifikuar personin me numër 10 që është A.D. të cilët ja kanë shitur veturën Opel Omega dhe atë ditë kur ja ka dhënë parat, A.D. ka shkuar tek parkingu i Viva Freshit ku ka ardhë edhe një veturë Golf 5 e ngjyrës së zezë dhe personi i identifikuar me numrin 3 që është Sh.L. A.i ka marrë të hollat ndërsa personi me numër të identifikimit 7 sipas foto dokumentacionit e që është I.Q. është personi që ka qenë në ulësen e vozitësit të veturës Golf 5 dhe se i kujtohet që kur ja ka dhënë çelësat e veturës A. D. i është kujtuar se A.i e ka përmendur emrin –Xeni dhe se pas kësaj A.i dhe Shl. kanë hip në veturën Opel Omega ndërsa personi me nr. 2 që ka qenë F.B. dhe ai me numër 7 që ka qenë I.Q. kanë vazhduar me veturën Golf 5 ngjyrë e zezë në drejtim të Matiqanit e që kjo vërteton përveç asaj që u tha më lartë për të akuzuarit tjerë, vërteton se ata kanë kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor. Nga vërtetimi mbi marrjen e sendeve të dt. 09.08.2014 është vërtetuar se nga i akuzuari Xh.Q. janë konfiskuar 34 hallka ari dore dhe stoli të tjera. Nga raporti i Agjensionit të Kosovës për forenzikë të dt. 16.06.2014 në Filialën e TEB Bankës dëshmia e gjetur G#16, e që është një qese najloni me ngjyrë të verdhë e të kuqe e gjetur në derën e djathtë të veturës Golf 4 me ngjyrë të kuqe me targa 01-683 FD ka rezultuar në përputhje gjegjësisht me rezultat pozitiv me shenjat e vijave papilare të gishtit nr. 3 të akuzuarit I.Q. e cila veturë është braktisur nga të akuzuarit pas ndjekjes nga ana e policisë pas kryerjes së grabitjes në TEB Bank. Prandaj bazuar në provat materiale dhe jo materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor, të analizuara dhe të arsyetuara nga gjykata e shkallës së parë e të cilat si të tilla i përkrahë edhe kjo gjykatë, pa mëdyshje u vërtetua se të akuzuarit Sh.L., I.Q. dhe F.B. në bashkëkryerje me të akuzuarit H.T. që gjendët në arrati kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK e që për të akuzuarit Shkelzen, I. dhe F. gjykata i ka shpallur fajtor për vepër penale në vazhdimësi, ndërsa i akuzuari Sh.K. ka kryer veprën penale të grabitjes nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK, ndërsa të akuzuarit Xh.Q., M.B., A.D., L.L. dhe D.A. kanë kryer veprën penale të dhënies së ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale ndërsa A.D. edhe të veprës penale Kanosje nga neni 185 par.1 të KPK si dhe i akuzuari V.B. veprën penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK.

Meqë në aktgjykimin e atakuar nuk kemi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të ligjit penal.

Duke shqyrtuar çështjen përkritazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve Sh.L., I.Q., F.B., Sh.K. dhe V.B. janë të bazuara, ndërsa ankesat e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ato të mbrojtësve të akuzuarve L.L., M.B. janë të pa bazuara. Prokuroria por edhe mbrojtësit e të akuzuarve L.L. dhe M.B. nuk kanë paraqitur ndonjë provë apo rrethanë e cila nuk ka qenë e njohur nga ana e gjykatës së shkallës së parë porse prokuroria thekson se gjykata nuk ka theksuar edhe rrethanat tjera rënduese siç është reflektimi negativ i këtyre veprave në pasigurinë e qytetarëve, humbjen e besimit dhe frikën e qytetarëve në sigurinë e bankave dhe hoteleve në Kosovë dhe se është dashur që dënimet të jenë më të larta me burg ndërsa mbrojtësit e të akuzuarve L dhe M. theksojnë se dënimi për të akuzuarin L ka qenë maksimal ndërsa për të akuzuarin M. se dënimi është i pa qëndrueshëm pasi gjendja faktike nuk është vërtetuar. Edhe pse mbrojtësit e të akuzuarve Sh.L. dhe F.B. aktgjykimin e atakuar nuk e atakojnë për shkak të vendimit mbi dënim, kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare duke aplikuar dispozitat e nenit 396 dhe 397 të KPP, të njëjtëve sikurse edhe të akuzuarve I.Q., Sh.K. dhe V.B. ua shqiptoj një dënim më të butë duke konsideruar se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë është i ashpër duke pas parasysh rrethanat lehtësuese të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe atë për të akuzuarit Sh.L., I.Q. dhe F.B. u mori si rrethanë posaçërisht lehtësuese rrethanat familjare si dhe kohën e kaluar në paraburgim, për të akuzuarin Sh.K. gjykata mori si rrethanë

lehtësuese se i njëjti është i martuar, baba i 3 fëmijëve, i vetmi mbikëqyrës i familjes, se në momentin e kryerjes së grabitjes në Swiss nuk ka qenë aktiv si të tjerët dhe si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata morri parasysh qëndrimin e tij në paraburgim. Për të akuzuarin Xh.Q. gjykata mori parasysh si rrethanë lehtësuese se i njëjti është familjar, baba i 3 fëmijëve dhe gjendjen e varfër ekonomike , ndërsa për të akuzuarin V.B. gjykata mori parasysh si rrethanë lehtësuese moshën e tij, baba i katër fëmijëve, pranimin e fajësisë dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris kurrfarë veprë penale, ashtu që kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nga ana e kësaj gjykate është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.54/18, më 06.03.2017

Procesmbajtëse,
Kimete Veseli

Kryetarja e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Have Haliti _____